



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA POGRADEC
KËSHILLI

Nr. 2642/8 Prot.

Pogradec, më 30.06. 2026

VENDIM

NR. 80, DATË 29.06. 2026

**MIRATIMI I PROCESVERBALIT TË MBLEDHJES SË DATËS 09.06.2026 TË
KËSHILLIT BASHKIAK POGRADEC**

Këshilli I Bashkisë Pogradec në mbledhjen e tij të datës së sotme, pasi lexoi proces-verbalin e zbardhur nga Sekretarja e Këshillit të mbledhjes së datës 09.06.2026, në mbështetje të ligjit nr. 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore" neni 53, pika 8 dhe neni 54, gërma k si dhe neni 92 e Rregullores së Funksionimit të Këshillit të Bashkisë Pogradec miratuar me VKB nr 40, datë 05.03.2020.

KËSHILLI I BASHKIAK

VENDOSI:

1. Të miratojë proces verbalin e mbledhjes të Këshillit të Bashkisë Pogradec , të datës 09.06.2026 bashkangjitur.
2. Kopja e proces verbalit të miratuar administrohet nga Sekretarja e Këshillit sipas procedurave ligjore.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARE E KËSHILLIT

Manjola KAMOLLI



1.Miratuar me 18 **vota**

2.Vota Pro 18

3.Vota Kundër 0

4.Vota Abstenim 0

5.Zbardhur më date 29.06.2026

Ubledhja jashle rradhe
dt 09.06.2026

Emri	Atesia	Mbiemri	Subjekti	Prezenca	Konflikt Interesi per Projekt- vendimet
Frederik	Mico	Pikuli	BF	V	
Marjeta	Feim	Biba	BF	H	
Ervin	Shpetim	Mancellari	BF	H	
Albana	Vladimir	Prifti	BF	V	
Klajdi	Albert	Gjona	BF	V	
Manjola	Petraq	Kamolli	PSSH	V	
Odhise		Mihallari	PSSH	V	
Brunilda	Merdan	Gora	PSSH	V	
Sara	Agim	Olldashi	PSSH	V	
Klea	Edmond	Topa	PSSH	V	
Ylli	Xhelal	Kasmollari	PSSH	H	
Silvana	Nikollaq	Bozda	PSSH	H	
Besnik	Bedri	Xhyra	PSSH	V	
Mimoza	Feti	Shuli	PSSH	V	
Jovan	Filip	Shkemb	PSSH	V	
Anila	Mihallaq	Gjoshe	PSSH	V	
Ahmed	Perparim	Guxholli	PSSH	V	
Miranda	Fidari	Olldashi	PSSH	V	
Mentor	Idriz	Rama	PSSH	H	
Elsona	Sotirag	Turshinka	PSSH	V	
Celnik	Rushit	Haxhillari	PSSH	V	
Vjollca	Tefik	Pllaha	PSSH	V	
Genci	Hamdi	Zyferi	PSSH	V	
Kejvi	Musa	Abrashi	PSSH	V	
Diogjen	Zarif	Qeva	PAA	V	
Zhaneta	Arif	Elezaj	PAA	V	
Engjell	Fluturak	Shyti	PD	V	
Alketa	Kujtim	Beka	PD	V	
Arber	Myzafer	Male	LZHK	V	
Liri	Neki	Seitllari	LZHK	H	
Suferin	Axhi	Dokollari	FRD	H	

ORA : 13:00

JANË PREZENT 21 KËSHILLTARË

PROTOKOLLI I MBLEDHJES SË KËSHILLIT BASHKIAK POGRADEC
DATE 09.06.2026 , ME KËTË REND DITE.

RENDI I DITËS

1. **Projekt – Vendim:** Miratimi i Rendit të ditës.
2. **Projekt – Vendim :** Miratimi i Procesverbalit të datës 28.05.2026.
3. Deklarimi I konfliktit të interesit nga këshilltarët, për vendimarrjen lidhur me cështjet e rendit të ditës.
4. Leximi I vendimeve dhe konfirmimet e prefektit për mbledhjen e datës 28.05.2026.
5. **Projekt – Vendim:** Për një shtesë në VKB Nr.128, datë 22.12.2025, “Për miratimin dhe detajimin e Buxhetit të Bashkisë Pogradec” (sistemimi I lumit Vërdove).
6. **Projekt – Vendim :** “ Për miratimin e hartës të hapësirave publike në Bashkinë Pogradec”
7. **Projekt – Vendim:** Për një ndryshim në VKB Nr.46, datë 29.05.2026 “Për miratimin e Kryerjes së Shërbimit me objekt: “Pastrimi, Grumbullimi dhe Largimi I Mbeturinave të qytetit të Pogradecit dhe Njësive Administrative.”
8. **Projekt – Vendim:** Për dhënie ndihmë financiare për znj. “Kristina Mekolli”.

Znj.Kryetare e Këshillit :Përpara se të fillojmë mbledhjen do të kërkoja të mbanim një minutë heshtje për Dëshmorin e Atdheut, z.Enea Mekolli.

Znj.Kryetare e Këshillit : I paharruar qoftë kujtimi I tij.

Pa humbur kohë fillojmë me mbledhjen jashtë rradhe të kërkuar nga Kryetari I Bashkisë sipas ligjit nr. 139/2015, neni 53, pika 4. Fillimisht do të votojmë për të future në Rendin e Ditës një projekt-vendim:

Për dhënie ndihme financiare për z. Edison Adri.

Pra bëhet fjalë për efektivin e policisë që mbeti I plagosur dhe vazhdoon trajtimet tek spitali I traumës.


Hedhim në votim Projekt-Vendimin: Për dhënie ndihme financiare për z. Edison Adri, për tu future në rendin e ditës.

Sekretare e Këshillit : Fillimisht po mar prezencën.

Prezent janë 21 këshilltarë, mbledhjen e deklaroj të hapur.

Miratohet për tu future në rëndin e ditës me 21 vota Pro.

Znj. Bojko: Janë prezent 21 këshilltarë. Mbledhja deklarohet e hapur.



1. Projekt – Vendim: Miratimi i Rendit të ditës.

Znj. Kryetare e Këshillit: Vazhdojmë me rendin e ditës. E hedhim në votim .

Sekretare e Këshillit: Miratohet me 21 vota Pro, pika e parë e rendit të ditës.

U votua

Pro 21

Kundër 0

Abstenim 0

Miratohet **Po** **Jo**

A handwritten signature in black ink, appearing to be 'J. B.', located at the bottom right of the page.

2. Projekt – Vendim :Miratimi i Procesverbalit të datës 28.05.2026.

Znj. Kryetare: Vazhdojmë atëherë me pikën e dytë të rendit të ditës. Nëse jemi dakord, e hedhim në votim. Ju lutem.

Sekretare e Këshillit: Miratohet me 21 vota Pro, pika e dytë e Rendit të ditës.

U votua

Pro 21

Kundër 0

Abstenim 0


Miratohet **Po** **Jo**

A handwritten signature in dark ink, appearing to be 'J. B.', is located in the bottom right corner of the page.

3. Deklarimi I konfliktit të interesit nga këshilltarët, për vendimarrjen lidhur me çështjet e rendit të ditës.

Znj. Kryetare: Vazhdojmë me pikën e tretë të rendit të ditës. E kemi shënuar në axhendë për të mos harruar që këshilltarët të shprehin konfliktin e interesit, nëse ka. Çdokush është i lirë të deklarojë konfliktin e interesit.

Meqënëse asnjë Këshilltar nuk ka konflikt interesi për pikat që do të trajtojmë vazhdojme me axhendën.

A handwritten signature in dark ink, appearing to be a stylized 'J' followed by a large 'B'.

Mbledhje e Këshillit Bashkiak

Pogradec më 09.06.2026

4. Leximi I vendimeve dhe konfirmimet e prefektit për mbledhjen e datës 28.05.2026.

Znj. Kryetare: Vazhdojmë me pikën e katërt të rendit të ditës. Lexohet konfirmimi nga Prefektura.

A handwritten signature in dark ink, appearing to be a stylized 'L' followed by a flourish.

5. Projekt – Vendim: Për një shtesë në VKB Nr.128, datë 22.12.2025, "Për miratimin dhe detajimin e Buxhetit të Bashkisë Pogradec" (sistemimi I lumit Vërdove).

Znj. Kryetare: Vazhdojmë me pikën e pestë të rendit të ditës.

Vjen Z.Arbër Male (ora 13:14) dhe Z.Diogje Qeva (ora 13:16)

I.Karapanca: Atëherë ky është një projekt që vlen 59 000 000 lekë , prej të cilave 47 600 000 lekë do të financohen nga Ministria dhe pjesa tjetër nga Bashkia. Fondi prej 12 000 000 lek është planifikuar që do të aplikohet për vitin 2027. Për pjesën inxhinierike do të flasë z. Paskalino.

Z. Paskalino: Bëhet fjalë për projektin e segmentit të rruga Unazë, përgjatë gjithë gjatësisë së lumit. Kemi menduar që do të veprojmë në të gjithë gjatësinë për sistemim jo vetëm tek pjesa ku është dëmtuar. Do të bëhet hapja dhe nga krahu tjetër I lumit që të mos kemi më probleme, të jetë një investim I qëndrueshëm. Ashtu sic tha dhe Irsa ky është një financim I Ministrisë dhe 20% mbulohet nga Bashkia Pogradec .

Znj.Kryetare: E diskutojmë dhe në komisione, e hedhim në votim pikën pesë të Rendit të ditës.


Sekretare e Këshillit: Miratohet me 23 vota Pro, pika pesë e Rendit të Ditës.

Pro 23

Kundër 0

Abstenim 0

Miratohet Po **Jo**



6. Projekt – Vendim: “ Për miratimin e hartës të hapësirave publike në Bashkinë Pogradec”

Znj. Kryetare: Vazhdojmë me pikën e radhës. Ju lutem, një informacion nga Znj E.Karafili.

Znj.E. Karafili: Përshëndetje, ne vijmë me këtë projekt-vendim mbas realizimit të konsultimit publik me të gjitha bizneset dhe qytetarët. Në hartë janë zbatuar me përpikmëri cfarë kërkon VKM, duke I lejuar qytetarëve dy metra ne trotuare në të gjithë qytetin .Tani kjo do pak kohë të implementohet sepse është pak e vështirë por si fillim do ecim me miratimin e hartave që te fillojmë ti zbatojmë në përditshmëri. Pjesa e shëtitorës dhe lulishtes është 10 metra gjerësi. Përsëri këtu është zbatuar VKM, ku përcakton 30% të sheshit. Këtë vit ne mendojmë që ata të dalin me një pedanë vetëm pjesa poshtë, pa lejuar banak, vazo me lule dhe asnjë ndërtim tjetër. Kemi menduar që të jenë një standart, dhe cadrat të jenë me ngrë bezhë. Kjo do pak kohë që të implementohet , plus do kemi dhe mirëkuptime që të mos I rëndojmë bizneset.

Ë. Shyti: Nqs firma mer përsipër që ta bëjë logën sipas ngjyës që është vendosur?

P.Ziko: Cdo subjekt do aplikojë me projektin përkatës. Ideja është që të bëhet uniforme. Ne sot miratojmë hartën ku po vendosim disa kufizime maximale për shfrytëzimin e hapësirës publike.Trotuaret me parimin jo më shumë se 30% dhe jo me pak se 10 metër kalim për qytetarët, ndërsa hapësira e lulishtes është vendosur një fashë për shfrytëzimin e hapësiravë publike. Përsa I përket strukturës, duke marë ne konsideratë dhe VKM e cila minimizon lejat për strukturat në hapësirat publike, në bashkëpunim me AZHT , ku duhet të japë dhe ajo autorizimin përsa I përket hapësirave në vendet bregliqenore dhe bregdetare, do të miratohen por maksimalisht vetëm pedana që të mos vendosen tavolinat në bar. Vetëm pedan horizontale, pa vazo lule pa struktura të tjera.

E.Karafili: Dhe duke parë që vitin tjetër mund të filloje Lungo-Gjoli, kemi menduar të jemi pak elastikë në këtë pjesë që të mos I rëndojmë shumë bizneset.

Ë. Shyti: Kjo pyetje ishte më shumë për ta dëgjuar bizneset që të jenë dhe ata të qartë nga kjo pjesë.

P.Ziko: Unë personalisht kasha një ide tjetër që të mos kishte fare cadra, kush kishte hije peme të shfrytëzonte atë.

E.Karafili: Shumë biznese që kan hije peme përsëri nuk I shfrytëzojnë. Ata të gjithë kanë dorëzuar projektet e tyre që të mos vonohen, por ne gjithsesi do I orientojmë dhe do I ndihmojmë sit ë zhvillojnë aktivitetin e tyre.

A.Prifti: Përsa I përket cadrave, nuk janë dakort sepse ato janë të kushtueshme dhe cdo biznes I bije të blejë të reja.

Ë.Shyti: Cdo biznes bije dakort me kompaninë dhe I ndryshojnë.

P.Ziko: Këto janë kushte të vendosura në VKM dhe ne patjetër që do I zbatojmë.

Zh.Elezaj: Është studiuar sa tavolina do të vendosen ?

E. Karafili: Në lulishte është gjerësia 10 metra, dy rrjeshta I bijen , ndërsa tek pjesa e trotuarit nga matjet që kemi bërë I bije të nxjerin vetëm një tavolinë.

Z.Qeva: Ju thatë jemi në krah të bizneseve por nuk është e vërtetë. Vitin e kaluar I latë të investinin dhe ja u prishët, I fundosët fare, I mbytët në borxhe.

E.Karafili: Unë jam drejtoresha e taksave dhe flas vetëm për pedanat, dhe nuk ka pasur asnjë shqetësim. Po flasim për hapësirat publike për pedanat jo për strukturat. Leja për struktura merret me deklaratë paraprake dhe është përgjegjësi dhe e bizneseve.

Z.Qeva: Tani pedanat ai I ka duhet të blejë tjetër.

Z.Ziko: Pse të blejë tjetër kur ai I ka.

Z.Qeva: Po për cadrat?

Z. Ziko: Cadrat nuk I mban dot sepse nuk e lejon ligji.

K.Topa: Është bërë dhe një konsultim public për hapësirat publike. Një gjë është e sigurt që pedanat kanë sjellë zhvillim. Përsa I përket strukturave, ne thjesht I përshtatemi VKM që ka nxjerë qeveria. Ajo që duhet të bëjmë ne është që këto biznese të zbatojnë ato që ne miratojmë dhe në këtë mënyrë nuk do të kemi problematika. Kjo sallë ka qënë plot me biznese kur u bë konsultimi publik dhe asnjë nuk u ngrit të shprehej kundër pedanave.

A. Male: Nqs diskutohet që vitin tjetër do të fillojë lungo gjoli, pse po vendosim kaq kushte të cilat përkthehen dhe në shpenzime për bizneset. Tjetra duhet parë që a zbatohen lejat, dmth që a marrin aq sa paguhen. Këtu ka dhe një problem tjetër sepse e vendosim biznesin në kushte të pabarabarta.

E. Karafili: Të gjitha bizneset kanë marrë aq metra sa kanë kërkuar me kërkesë, asnjë nuk është penalizuar dhe kanë paguar për aq metra sa kanë. Dhe nqs kanë pasur më shumë metra se leja persëri kanë paguar për aq metra sa kanë mare, dhe këtë e them me siguri të plotë, madje ja u vendos dhe në dispozicion lejat e cdo biznesi me konstatimet përkatëse.

Znj. Kryetare: Atëherë e hedhim në votim.

Pro 20

Kundër 2 (D.Qeva; Zh.Elezaj)

Abstenim 1 (A.Male)

Miratohet **Po** **Jo**

Sekretare e Këshillit: Miratohet me 20 vota Pro, pika hjashtë e Rendit të Ditës.



7. Projekt – Vendim: Për një ndryshim në VKB Nr.46, datë 29.05.2026 “Për miratimin e Kryerjes së Shërbimit me objekt: “Pastrimi, Grumbullimi dhe Largimi I Mbeturinave të qytetit të Pogradecit dhe Njësive Administrative.”

E. Kamolli: Lidhur me shërbimin e pastrimit në qytetin e Pogradecit dhe Njësitë Administrative, ne 22.09 2025 Bashkia Pogradec ka lidhur marrëveshje kuadër me kompaninë e pastrimit Rei Shpk, me afat 48 muaj me vlerë të përgjithshme 516 milion lekë me TVSH. Në dhjetor të vitit 2025 hyn në fuqi Vkm nr 776, datë 19.12.2025 “Për përcaktimin e pagës minimale në shkallë vendi”. Ky projekt-vendim lidhet pikërisht me këtë VKM dhe efektet që kjo ka sjellë në kontratën që ne kemi lidhur me kontraktorin. Pas publikimit të VKM, kontaktori ka sjellë disa kërkesa pranë Bashkisë Pogradec, ku kërkon kompensimin e pagës minimale, për punonjësit me pagë minimale. Është ngritur një grup pune nga titullari enkas për studimin e rastit nëse legjitimohet për kompensimin e pagës minimale. Grupi I punës e ka studiuar dhe ka dalë në konkluzion që I takon kompensimi. Janë llogaritur efektet dhe është studiuar që marrëveshja kuadër të llogaritet për një periudhë nga 48 muaj në 46 muaj.

C. Haxhillari : Duhet të kemi parasysh sepse kjo është një procedurë tenderimi dhe nuk është e ndershme që të ulim afatet, sepse ne para se të marim vendimin duhet të biem dakort me kontraktuesin, pra me firmen.

E. Kamolli: Procedura e tenderimit ka disa rregulla dhe kushte të marrëveshjes. Sipas ligjit të tenderimit ekziston një pikë, konkretisht në kontratë, është neni 19 dhe thotë që: Nëse pas nënshkrimit të kontratës hyjnë efekte ligjore ose nenligjore që presin çmimin e kontratës, do të kompensohen për kushtet që do të preken.

C.Haxhillari: Dakort por nuk ulet afati I kontratës.

D. Babasuli: Ne kemi diskutuar me kontraktorin dhe është dakort për këtë kusht.

A. Male: Unë kasha dicka tjetër për të thënë pasi e kam ngritur dhe një herë tjetër si shqetësim monitorimin e zbatimit të kontratës së pastrimit. Ky grup pune që është ngritur ka bërë gjithë verifikim si janë zbatuar kushtet e kontratës në njësitë administrative dhe në qytetin e Pogradecit. Në kontratë keni makineritë teknologjike, kemi pastrimin dhe largimin e mbetjeve në Njësitë administrative. Ndërkohë që situata është në gjendje jo të mirë. Kazanet e mbeturinave nuk pastrohen.

D.Babasuli: Është bërë kalkulimi bazur në llogaritjen e formulës që ka miratuar ministria dhe është parë që vetëm 39 punonjës janë llogaritur me pagë minimale. Pjesa e monitorimit është



marrë nga të gjitha raportet që kanë ardhur. Përsa I përket cilësisë së kazaneve firma nuk është e angazhuar për ndërimin e kazaneve.

Kompania I ka blerë kazanet 7-8 vjet para, jemi në diskutim për blerjen e kazaneve të reja sidomos në zonat turistike.

Pro 18

Kundër 4 (D.Qeva; Zh.Elezaj, A.Male; K.Gjona)

Abstenim 1 (A.Prifti)

Miratohet **Po** **Jo**

Sekretare e Këshillit: Miratohet me 18 vota Pro, pika tetë e Rendit të Ditës.



9. Projekt – Vendim: Për dhënie ndihmë financiare për znj. “Kristina Mekolli”.

Kryetare e Këshillit: Nuk ka nevojë për fjalë, e hedhim në votim


Pro 23

Kundër 0

Abstenim 0

Miratohet **Po** **Jo**

Sekretare e Këshillit: Miratohet me 23 vota Pro, pika nëntë e Rendit të Ditës.



10. Projekt – Vendim: Për dhënie ndihmë financiare për z.Edison Adri .

Kryetare e Këshillit: Nuk ka nevojë për fjalë, e hedhim në votim.

A.Gjoshe: Unë kasha një propozim që tja vendosim vlerën e njëjtë sepse e kam ndjekur rastin personalisht dhe rikuperimi kërkon kohë dhe kushton

I. Karapanca: Ishte një propozim nga këshilli dhe e vendosem për të patur dhe një diferencë nga familja e të ndjerit, gjithsesi nqs do të duhet vijmë me projekt-vendim tjetër.

Pro 23

Kundër 0

Abstenim 0

Miratohet Po Jo

Sekretare e Këshillit: Miratohet me 23 vota Pro, pika dhjetë e Rendit të Ditës.

KRYETARE E Këshillit: Mbledhjen e deklaroj të mbyllur.

Sekretare e Këshillit
Jona Boyko

